

Kushte dhe Terma të Përgjithshme për Blerje

Shqipëri

KUSHTE DHE TERMA TE PERGJITHSHME PER SHERBIME

Këto Kushte dhe Terma do të lexohen së bashku me urdhër blerjen ("Urdhër Blerje", ose "UB") midis kompanisë Novartis të identifikuar në Urdhër Blerje (në tekstin e mëtejshëm referuar si "Novartis") dhe furnizuesit të identifikuar në Urdhër Blerje (në tekstin e mëtejshëm referuar si "Furnizues") dhe, përveç rastit të zëvendësimit nga një kontratë e vecantë mes Palëve, do të rregullojë marrëdhënien deri në përfundim të plotë të kushteve dhe termave të Furnizuesit. Novartis dhe Furnizuesi referohen veçmas si Pala dhe së bashku si Palët.

1 Përkufizimet

"Filial" do të thotë çdo subjekt biznesi që kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën kontroll të përbashkët nga Novartis. Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, një subjekt biznesi do të konsiderohet se "kontrollon" një biznes tjetër nëse ai (a) zotëron, drejtpërdrejt ose indirekt, kompetencat për të drejtuar menaxhimin ose politikën e subjektit të biznesit, qoftë përmes pronësisë së titujve të votimit ose nga një kontratë mbi të drejtat e votimit ose të qeverisjes së shoqërisë (b) të zotërojë, drejtpërdrejt ose indirekt, më shumë se pesëdhjetë përqind (50%) të titujve të lëshuar të votimit ose përqindje tjetër pronësie të një subjekti biznesi të tillë; ose (c) në rastin e një partneriteti, kontroll mbi partnerin e përgjithshëm.

"Marrëveshje" do të thotë këto Kushte dhe Terma të Përgjithshme për Shërbime, UB, çdo dhe të gjitha oraret e Urdhër Blerjes.

"Humbje" nënkupton çdo dhe të gjitha humbjet, detyrimet, pretendimet, kërkesat, shkaqet e veprimet, gjykimet, dëmtimet, gjambat, paditë, veprimet, kostot, shpenzimet, përfshirë interesin, gjambat, tarifën e arsyeshme profesionale dhe tarifën e arsyeshme të avokatëve bazuar në marrëdhënien avokat/klient të bashku me disbursimet.

"Produkte" do të thotë të gjithë artikujt, të mirat, materialet, mallrat dhe produktet e tjera (përfshirë por pa u kufizuar nga programet kompjuterike), të dhëna siç përcaktohen në Urdhër Blerje, të cilat furnizohen, dorëzohen ose vihen ndryshe në dispozicion ose për t'u furnizuar, dorëzuar ose vënë në dispozicion të Novartis nga Furnizuesi.

"Urdhër Pagesa" nënkupton konfirmimin me shkrim nga Novartis për një kuotë, propozim ose ofertë të dërguar nga Furnizuesi.

"Shërbime" do të thotë të gjitha shërbimet e përcaktuara në Urdhër Blerje ose një deklaratë të detajuar të punës (nëse aplikohet) që ofrohet, furnizohet ose vihet në dispozicion të Novartis.

"Deklarata e Punës ose DP" nënkupton një deklaratë të detajuar të punës, urdhrin të punës ose urdhrin të detyrës që përfshin përshkrimin e të gjitha tarifave dhe kostove të aplikueshme për Shërbimet dhe Produktet që ofrohen dhe një orar të pagesës përkatëse. Një DP do të jetë pjesë e një marrëveshjeje të veçantë të ekzekutuar midis Palëve.

2 Emërimi

2.1 Furnizuesi do të kryejë ato Shërbime që mund t'i caktohen herë pas here Furnizuesit nga Novartis, siç përcaktohet në UB. Shërbimet do të kryhen në kohën dhe vendet e dakordësuara bashkarisht ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshjeje.

3 Pagesa dhe Faturimi

3.1 Në rishikimin e Shërbimeve të kryera në përputhje me këtë Marrëveshje, Furnizuesi do t'i paraqesë Novartis një faturë të detajuar për tarifën që duhet paguar siç specifikohet në UB. Taksa mbi vlerën e shtuar duhet të tregohet veçmas. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për të siguruar që të gjitha faturat të lëshohen shpejt dhe në kohë, siç është rënë dakord midis Palëve. Novartis do të paguajë të gjitha faturat e pakontestuar, sipas çdo afati pagese të rënë dakord me shkrim.

3.2 Pagesa do të bëhet me marrjen e faturës nga Novartis në përputhje me Kontratën ose Urdhrin e Blerjes. Pas përfundimit të Shërbimeve, fatura(t) mund të dërgohen ose në kopje origjinale në letër në selinë e shoqërisë të treguar më poshtë, në rastet kur furnizuesi nuk ka implementuar sistemin e faturave elektronike tatimore, ose faturat mund të merren nga punonjësi i Novartis që ka kërkuar shërbimin në sistemin e faturave elektronike tatimore, ose kur kërkohet nga punonjësi i Novartis, furnitori duhet të dërgojë faturën në adresën e emailit

al.nphs@novartis.com duke shënuar në objekt "Novartis Pharma Services Inc-Albania – Ref: PO Nr. 41xxxxxxx". Subjekti i saktë duhet të adresohet në faturë siç tregohet më poshtë:
Novartis Pharma Services Inc.
Zyrë Përfaqësimi në Shqipëri
Rruga "Hoxha Tasim" , Nr.23
Tiranë, Shqipëri

Çdo faturë duhet të shoqërohet me të gjitha faturat origjinale të shpenzimeve ose dëshmi të tjera të pagesës për të cilat kërkohet rimbursimi. Nëse ndonjë nga kriteret nuk përcaktohet në faturë, Novartis do t'ia kthejë faturën Ofruesit të Shërbimit dhe nuk do të vazhdojë me pagesën. Fatura do të kthehet në rast të skenarëve të mëposhtëm:

- Në faturë mungojnë elementët e përcaktuar nga ligji "mbi Fiskalizimin", artikulli 9 edhe Ligji për TVSH-në, artikulli 101.
- Numri i Urdhër Blerjes nuk është shënuar /Numri UB i shënuar është i gabuar.
- Personi i kontaktit në Novartis ose ndonjë person tjetër i caktuar nga Novartis nuk përmendet në faturë
- Monedha e UB nuk është e njëjtë me monedhën e faturës

3.3 Të gjitha tarifat dhe kostot duhet të tregohen pa përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar, por përfshijnë kostot e tjera siç janë kostot e administratës. Rritja e tarifave dhe kostove do të ndodhë vetëm nëse bien dakord reciprokisht me shkrim të dyja Palët. Asnjë kuotim, propozim ose ofertë nuk do të konsiderohet e pranuar nga Novartis derisa të shoqërohet dhe ekzekutohet me një Urdhër Blerje Novartis, i cili mban një numër zyrtar të urdhër blerjes Novartis, përveç në rastet kur kërkohen shërbime shtesë ose variante të shërbimeve, të cilat lidhen me një Urdhër Blerje zyrtar dhe të ekzekutuar Novartis.

3.4 Asnjë nga shpenzimet shtesë të bëra nga Furnizuesi ose punonjësit e Furnizuesit për kryerjen e Shërbimeve nuk do të paguhet nga Novartis përveç nëse kjo është rënë dakord posaçërisht. Kur është rënë dakord për rimbursimin, shpenzimet e tilla shtesë duhet të jenë të arsyeshme dhe të bëra nga punonjësit e Furnizuesit në mënyrë të vlefshme për kryerjen e Shërbimeve dhe të garantuara nga faturat ose dëshmitë e tjera të pagesës aktuale. Në asnjë rast Novartis nuk është i detyruar të kompensojë shpenzimet të cilat janë më shumë se kufijtë e rënë dakord posaçërisht. Të gjitha shpenzimet e tilla do t'i ngarkohen furnizuesit dhe duhet të detajohen në faturën e përmendur në pikën 3.1 më lart.

4 Kryerja e Shërbimeve

4.1 Furnizuesi do të sigurojë Shërbimet në përputhje me standardet e kujdesit dhe aftësive që priten në mënyrë të arsyeshme nga një ekspert kompetent në fushën e ofrimit të shërbimeve me natyrën e përgjithshme të Shërbimeve.

4.2 Furnizuesi bie dakord të korrigjojë, pa pagesë, çdo gabim në punën e Furnizuesit që nuk është për shkak të ndonjë gabimi, veprimi ose mosveprimi të Novartis dhe të cilat ose bëhen të dukshme për Furnizuesin ose të cilat i njoftohen Furnizuesit me shkrim nga Novartis.

4.3 Në varësi të marrëveshjes me Novartis, Furnizuesi NUK mund të nën-kontraktojë Shërbimet.

4.4 Furnizuesi do t'i kryejë Shërbimet në vende të tilla të identifikuar në UB, përveç nëse kërkohet ndryshe nga Novartis.

4.5 Furnizuesi siguron që i gjithë personeli që kryen Shërbimet ("Stafi") të ketë kualifikimet, njohuritë dhe përvojën e nevojshme. Nëse në çdo kohë, Novartis beson sipas mendimit të tij të arsyeshëm se Stafi është i papërshtatshëm për të kryer Shërbimet, Furnizuesit do t'i kërkohet nga Novartis që brenda një kohe të arsyeshme, ta zëvendësojë këtë personel me një personel të përshtatshëm.

4.6 Furnizuesi do të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të përmbushur çdo kërkesë nga Novartis për të ndryshuar ose ndaluar ndonjë plan ose për të refuzuar ose anuluar çdo punë në procesin e përgatitjes, për aq kohë sa kjo është e mundur brenda objektit të detyrimeve kontraktuale të Furnizuesit ndaj furnizuesve të tij . Novartis do të jetë përgjegjës për çdo tarifë të paguar siç duhet nga furnizuesi në përputhje me dhe në kohën e duhur siç kërkohet, përpara ose për shkak të anulimit ose ndryshimit që nuk mund të rikuperohet në mënyrë të arsyeshme nga Furnizuesi. Për shmangien e dyshimit, Furnizuesi është i detyruar të zvogëlojë humbjet e tij gjithmonë dhe Novartis nuk do të jetë përgjegjës të paguajë ndonjë pjesë të tarifës në lidhje me periudhën pas anulimit ose ndryshimit.

4.7. Novartis ka të drejtë të refuzojë mallrat me defekte të dukshme brenda 30 ditëve nga pranimi në vendndodhjen e rënë dakord dhe mallrat me defekte të fshehura brenda 30 ditëve nga zbulimi i tyre. Në mënyrë të barabartë, Furnizuesi do të përballojë cilëndo dhe të gjitha kostot që vijnë nga cilësia e dobët e mallrave të dërguara (përfshirë por pa u kufizuar në kthimin, asgjësimin, transportin e mallrave të reja, ripaketimin, etj.).

5 Dëmshpërblimi dhe Sigurimi

5.1 Përveç çdo mjeti tjetër juridik në dispozicion të Palëve, secila palë do të mbrojë, dëmshpërblejë dhe mbajë jashtë përgjegjësisë palën tjetër, Filialet e saj dhe zyrtarët, drejtorët, partnerët, aksionarët, punonjësit dhe agjentët nga dhe kundër të gjitha humbjeve të pësuar prej tyre në masën që rrjedh ose lind nga ose në lidhje me: (a) çdo shkelje të ndonjë detyrimi të kësaj Marrëveshjeje nga Pala tjetër, dhe (b) zbatimin e të drejtave të një Pale sipas këtij neni 5, përveç kur Humbje të tilla lindin si rezultat i pakujdesisë, mashtrimit, sjelljes qëllimisht të gabuar ose veprimit të gabuar të palës së dëmshpërblyer, Filialeve të saj ose zyrtarëve, drejtorëve, partnerëve, aksionarëve, punonjësve ose agjentëve përkatës.

5.2 Furnizuesi do të ruajë dhe mirëmbajë gjatë afatit të kësaj Marrëveshjeje mbulimin e sigurimit të llojeve dhe shumave që barten zakonisht nga ofruesit e shërbimeve, siç janë Shërbimet në fushën e biznesit të Furnizuesit dhe sigurohen nga kompanitë e sigurimeve me reputacion të mirë.

6 Konfidencialiteti

6.1 Furnizuesi do të ruajë, teksa kjo Marrëveshje mbetet në fuqi dhe për 10 vjet pas përfundimit, konfidencialitetin e çdo dhe të gjitha informacioneve tregtare dhe teknike në lidhje me cilindo prej produkteve, bizneseve, veprimtarive kërkimore dhe/ose zhvillimore ekzistuese ose të planifikuara, klientët dhe furnitorët e Novartis dhe/ose ndonjë kompani filial ose partnere të Novartis dhe të gjitha informacionet e tjera që lidhen me Novartis dh /ose ndonjë ndërmarrje filial ose partnere të Novartis dhe/ose për ndonjë nga aktivitetet ose çështjet financiare të Novartis ose ndonjë ndërmarrje të tillë filial ose partnere të cilën ajo mund ta blejë ose në të cilën mund të ketë qasje gjatë ose në bazë të kësaj konsulence dhe çdo informacioni të gjeneruar në lidhje me konsulencën ("Informacioni Konfidencial"). Informacioni Konfidencial do të përdoret nga Furnizuesi për qëllimin e vetëm të ofrimit të Shërbimeve dhe nuk do të shpërndahet, në asnjë kohë teksa kjo Marrëveshje është në fuqi dhe më pas, nga Furnizuesi ndaj ndonjë palë të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Novartis. Të gjitha Informacionet Konfidenciale do të qëndrojnë gjithnjë në pronë të Novartis.

6.2 I gjithë Informacioni Konfidencial dhe çdo informacion tjetër në çfarëdo forme ose medium të furnizuar nga Novartis tek Furnizuesi do t'i dërgohet menjëherë Novartis sipas kërkesës në çdo kohë, teksa kjo Marrëveshje mbetet në fuqi ose pas kësaj.

6.3 Novartis pranon që si pjesë e aktiviteteve të veta të biznesit, Furnizuesi mund të dëshirojë të sigurojë, gjejë ose kryejë ose sigurojë kryerjen për një palë të tretë, të çdo shërbimi që ka të bëjë me ose merret me zhvillimin, prodhimin, marketingun, promovimin ose shitjen e ndonjë produkti i cili është ose i njëjtë me, i ngjashëm me, konkurrues me, ose kryen të njëjtin funksion në të njëjtën mënyrë ose në të njëjtën zonë terapie, si cilido prej produkteve ose ndonjë pjese të tyre, me të cilën lidhen Shërbimet ("Shërbimet Konfliktuale"). Furnizuesi do të njoftojë Novartis përpara se të angazhohet të kryejë ndonjë Shërbim Konfliktual, dhe Novartis nuk do të heqë paarsyeshmërisht pëlqimin e tij, me kusht që Furnizuesi të tregojë se ka kapacitetin e duhur sëbashku me proceset dhe procedurat në fuqi të biznesit në mënyrë të tillë që të mbrojë plotësisht informacionin konfidencial të Novartis kur merret me ndonjë Shërbim Konfliktual të tillë.

7 Pronësia Intelektuale (IP)

7.1 Të gjitha modelet, zhvillimet, idetë, zbulimet, shpikjet dhe informacionet që kanë aplikim të mundshëm në cilindo biznes të Novartis ose ndonjë prej kompanive bija ose filiale të veta, të modeluara, zhvilluara, zbuluara, shpikura, prodhuara ose të lindura në rrjedhën e, ose si rezultat i ofrimit të Shërbimeve nga Furnizuesi, do t'i jepet Novartis dhe do të jetë pronë e vetme dhe absolute e Novartis për t'u trajtuar siç Novartis mendon se është e përshtatshme. Të gjitha modelet, zhvillimet, idetë, zbulimet, shpikjet dhe informacionet e tilla do të jenë pjesë e informacionit konfidencial. Në rast se Novartis vendos, sipas gjykimit të vet, të kërkojë patentë,

të drejtën e autorit ose mbrojtje tjetër (qoftë në Shqipëri apo gjetkë) në lidhje me ndonjë prej këtyre, Furnizuesi do të bashkëpunojë plotësisht me Novartis në përpilimin e çdo aplikacioni të nevojshëm duke kërkuar, marrjen ose mirëmbajtjen e patentës, të drejtat e autorit ose mbrojtje tjetër subjekt i Novartis duke mbajtur të gjitha kostot dhe shpenzimet e nevojshme në lidhje me të.

7.2 Furnizuesi do të vëzhgojë të gjitha të drejtat e autorit në materialin e shkruar, përfshirë softuerin kompjuterik, që i përket Novartis ose ndonjë pale të tretë, dhe Furnizuesi nuk do të bëjë asnjë kopje të paautorizuar të këtij materiali ose software.

7.3 Furnizuesi do të dëmshpërblejë Novartis kundër çdo pretendimi për shkelje të letrave të patentave, modeleve të regjistruara, markave tregtare ose të drejtave të autorit që rrjedhin nga përdorimi prej Novartis i Shërbimeve të furnizuara nga Furnizuesi dhe për të gjitha kostot dhe dëmet që Novartis mund të pësojë nga ndonjë veprim për të tilla shkelje, ose për të cilin Novartis mund të bëhet përgjegjës.

7.4 Secila Palë pranon që pala tjetër ka në pronësi shpikje të caktuara, procese, njohuri, sekrete tregtare, përmirësime dhe IP të tjera të cilat janë zhvilluar në mënyrë të pavarur nga secila Palë dhe që kanë të bëjnë me biznesin ose operacionet e asaj Pale. Pranohet që prona intelektuale që zotërohet nga secila Palë në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje do të mbetet pronë ekskluzive e palës zotëruese. Furnizuesi i jep Novartis dhe filialeve të veta, si dhe furnizuesve të tyre, punonjësve, kontraktorëve, agjentëve dhe këshilltarëve, një licencë të vazhdueshme jo-ekskluzive, pa pagesë, në të gjithë botën, për të përdorur prona intelektuale para-ekzistuese të Furnizuesit si të jetë e nevojshme për të përfutur shërbimet ose çdo gjë që lind prej tyre për qëllimet e biznesit të Novartis ose filialeve të veta.

8 Marrëdhënia midis Palëve

Marrëdhënia e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje është ajo e kontraktuesve të pavarur. Furnizuesi nuk do të bëjë asnjë blerje ose të mbartë ndonjë përgjegjësi në vend të Novartis dhe as të detyrojë në ndonjë mënyrë Novartis dhe as të ndërmarrë ndonjë veprim që ka të ngjarë të merret nga palët e treta sikur Furnizuesi është duke vepruar si agjent i Novartis, përveç se me autorizimin e posacëm të shkruar paraprakisht nga Novartis.

9 Përfundimi

9.1 Kjo Marrëveshje do të vazhdojë deri në përfundimin e Shërbimeve, duke iu nënshtuar përfundimit të mëhershëm siç përcaktohet këtu. Novartis në çdo kohë mund t'i japë furnizuesit 10 ditë njoftim me shkrim për përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, rast në të cilin Furnizuesi do të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshme për të ndryshuar ose ndaluar ndonjë plan ose për të refuzuar ose anuluar çdo punë në procesin e përgatitjes, për aq sa kjo është e mundur brenda objektit të detyrimeve kontraktuale të Furnizuesit ndaj furnizuesve të tij. Novartis do të jetë përgjegjës për çdo tarifë të pësuar nga Furnizuesi në përputhje me afatet e pranuar për ofrimin e Shërbimeve, përpara ose si rezultat i anulimit ose ndryshimit, të cilat nuk mund të rikuperohen në mënyrë të arsyeshme nga Furnizuesi. Për shmangien e dyshimit, Furnizuesi është i detyruar të zvogëlojë humbjet e tij në çdo kohë dhe Novartis nuk do të jetë përgjegjës të paguajë ndonjë pjesë të tarifës për periudhën pas anulimit ose ndryshimit.

9.2 Novartis mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje menjëherë duke njoftuar me shkrim nëse Furnizuesi:

9.2.1 Kryen ndonjë shkelje të kushteve të kësaj Marrëveshjeje ose të ndonjë prej politikave, rregullave dhe rregulloreve të përmendura këtu, duke përfshirë por pa u kufizuar në Kodin e Palës së Tretë të Novartis; ose

9.2.2 Bëhet fajtor përmes zyrtarëve, punonjësve ose agjentëve të tij për çdo sjellje të gabuar dhe / ose sjellje tjetër të llogaritur se është paragjyquese për interesat e Novartis ose për kryerjen efikase të Shërbimeve; ose

9.2.3 Neglizhon, dështon, refuzon ose nuk është në gjendje t'i kryejë të gjitha shërbimet e mëposhtme me standardet e kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Novartis; ose

9.2.4 Falimenton ose bën marrëveshje me kreditorët e tij, ose cakton një likuidues ose përfitues të caktuar ose fillon të shkrihet (përveç se për qëllime të bashkimit ose rindërtimit).

9.3 Pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, Furnizuesi do t'i dorëzojë menjëherë Novartis të gjitha kopjet në letër dhe format e tjera të Informacionit Konfidencial dhe të gjitha korrespondencat, dokumentet, specifikimet dhe çfarëdo pasurie tjetër që i përket Novartis, e cila mund të jetë në posedimin e vet.

10 Mbrojtja e të Dhënave

10.1 Kur Furnizuesi përpunon të dhënat personale në emër të Novartis për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, Furnizuesi do të jetë një përpunues i të dhënave. Furnizuesi garanton Novartis se:

10.1.1 Do t'i përpunojë këto të dhëna personale vetëm në emër të Novartis për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje ose në përputhje me udhëzimet e Novartis herë pas here.

10.1.2 Nuk do të caktojë asnjë nën-përpunues të të dhënave pa pëlqimin paraprak me shkrim të Novartis dhe në çdo rast vetëm me kusht që këto nën-përpunues të të dhënave janë angazhuar me kushte që t'i ofrojnë të drejta ekuivalente Novartis përballë nën-përpunuesve të të dhënave, dhe mbrojtje ekuivalente në lidhje me të dhënat personale të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

10.1.3 Do të marrë masat e duhura teknike dhe organizative kundër përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm të të dhënave personale dhe kundër humbjes aksidentale ose shkatërrimit, ose dëmtimit të të dhënave personale, përfshirë pa kufizim të gjitha dispozitat e sigurisë, të cilat i këshillohen Furnizuesit nga Novartis;

10.1.4 Do të sigurojë që ata punonjës që kanë qasje në të dhënat personale gjatë ofrimit të Shërbimeve kanë kaluar nivele të arsyeshme të trajnimit mbi mbrojtjen e të dhënave;

10.1.5 Nuk do t'i ndajë të dhënat personale me palë të treta pa pëlqimin paraprak me shkrim të Novartis dhe;

10.1.6 Nuk do t'i përpunojë të dhënat e tilla personale jashtë Shqipërisë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Novartis dhe më pas t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi të arsyeshëm shtesë të vendosur nga Novartis.

10.2 Furnizuesi bie dakord, dhe do të sigurojë që çdo nën-përpunues i të dhënave bie dakord, që Novartis ose agjentët e tij në çdo kohë pasi të kenë dhënë një njoftim të arsyeshëm, të mund të kërkojnë të drejta të tilla të arsyeshme të hyrjes dhe të auditimit të duhur për të vlerësuar që Furnizuesi ose nën-përpunuesi i të dhënave është në pajtueshmëri me nenin 10.

10.3 Në rast të ndonjë qasje të paautorizuar ose aksidentale në, ose përdorim ose shpërndarje të të dhënave personale për të cilat Novartis është kontrollues i të dhënave, ose në rastin kur Furnizuesi ka besim të arsyeshëm se ndonjë qasje, përdorim ose shpërndarje e tillë ka ndodhur, Furnizuesi do të (1) njoftojë Novartis menjëherë duke dhënë detaje të arsyeshme të ndikimit në Novartis të qasjes, përdorimit dhe shpërndarjes si dhe veprimit korrigjues të ndërmarre ose që do të ndërmerret dhe (2) do të ndërmarre çdo veprim të kërkuar nga ligji i zbatueshëm që ka të bëjë me këtë hyrje, përdorim ose shpërndarje.

10.4 Furnizuesi do të dëmshpërblejë Novartis kundër gjobave, humbjeve ose dëmtimeve që Novartis mund të marrë ose pësojë si rezultat i ndonjë shkelje nga furnizuesi i dispozitave të kësaj klauzolë 10.

10.5 Pronësia mbi të dhënat personale të përmendura në këtë klauzolë 10, dhe mbi të drejtat themelore të pronësisë intelektuale për këto të dhëna, do të mbetet e Novartis dhe/ose të të licencuarve të vet.

11 Njoftim

11.1 Cdo njoftim që kërkohet sipas kësaj Marrëveshjeje, që do t'i jepet secilës Palë, do të jetë me shkrim dhe do të kryhet duke u dërguar me postë ose korrier të regjistruar në adresën e palës tjetër të deklaruar në këtë Marrëveshje, ose cdo adresë tjetër që mund të jetë njoftuar kohë pas kohe me një njoftim të dhënë në përputhje me këtë klauzolë.

11.2 Cdo njoftim i dhënë në përputhje me nenin 11.1 i cili nuk i është kthyer dërguesit si i padorëzuar, konsiderohet se është dorëzuar në ditën e dytë pasi është postuar zarfi.

12 Ligji i zbatueshëm dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në të gjitha aspektet në përputhje me ligjet e Shqipërisë. Cdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me këtë Marrëveshje, përfshirë vlefshmërinë, interpretimin dhe ekzekutimin e saj, që Palët nuk mund të zgjidhin miqësisht brenda 30 ditëve pune, do t'i referohet menjëherë Përfaqësuesit më të vjetër, i cili ka autoritetin e duhur për të detyruar Palën përkatëse ("Përfaqësuesit e Emëruar"), i cili do të përpiqet të zgjidhë mosmarrëveshjen brenda një periudhe prej pesë (5) ditësh pune nga skadimi i periudhës 30 ditore (ose një periudhë më e gjatë siç mund të bihet dakord me shkrim ndërmjet

Palëve). Në rast se Përfaqësuesit e Emëruar nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen brenda 5 ditësh pune (ose një periudhe të dakordësuar më të gjatë), secila Palë do të ketë të drejtë të paraqesë mosmarrëveshjen në juridiksionin ekskluziv të gjykatave kompetente të Shqipërisë.

13 Amendimi ose Ndryshimi

Cdo amendim ose ndryshim i kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dy Palët.

14 Garanci

14.1 Novartis do të mbështetet në aftësinë, ekspertizën dhe përvojën e Furnizuesit në ofrimin e Shërbimeve, saktësinë e të gjitha përfaqësimeve dhe deklaratave të bëra dhe këshillave të dhëna nga Furnizuesi në lidhje me ofrimin e shërbimeve.

14.2 Furnizuesi paraqet dhe garanton që:

14.2.1 Deklaron se nuk ka ndonjë interes financiar tek Novartis; ndonjë të afërm të afërt ose miq të ngushtë me një interes financiar tek Novartis; ndonjë paragjykim ose prirje personale e cila në ndonjë mënyrë do të ndikonte në vendimet e tyre në lidhje me Novartis dhe nuk ka ndonjë detyrim, aleancë ose besnikëri personale e cila në ndonjë mënyrë do të ndikonte në vendimet e tyre në lidhje me Novartis.

14.2.2 Merr përsipër të bëjë një deklaratë të mëtejshme, ku detajon çdo konflikt, konflikt të mundshëm ose konflikt të dukshëm që mund të lindë gjatë periudhës së kontratës. Pranon të abstenojë nga çdo vendim nga i cili buron një konflikt i tillë.

14.2.3 Ka zotësi dhe autoritet të plotë për të hyrë në këtë Marrëveshje dhe për të furnizuar Shërbime me kushtet e parashikuara këtu;

14.2.4 Sigurimi dhe / ose përdorimi i Shërbimeve nuk do të përbëjë në asnjë mënyrë një cenim ose shkelje tjetër të ndonjë të drejte të Pronësisë Intellektuale të ndonjë pale të tretë;

14.2.5 Në të gjitha shtetet ku Shërbimet janë ofruar ose janë vënë në dispozicion, do të respektojë të gjitha ligjet në fuqi dhe rregulloret përkatëse dhe do të marrë dhe mirëmbajë me koston e vet të gjitha licencat, pëlqimet dhe lejet e nevojshme për të kryer shërbimet.

15 Përdorimi i Emrit

Furnizuesi nuk do të përmendë ose të përdorë ndryshe emrin, shenjën, simbolin, markën tregtare, emrin tregtar ose logotipin e Novartis ose të ndonjë prej bashkëpunëtorëve të tij në ndonjë botim, njoftim për shtyp, material promovues ose formë tjetër të publicitetit pa pëlqimin paraprak me shkrim të Novartis. Një pëlqim i tillë duhet të jepet për secilin rast përdorimi.

16 Cedimi

Kjo Marrëveshje dhe çdo detyrim i mëtejshëm mund të cedohet ose transferohet nga Novartis tek një Filial.

17 Vlefshmëria

Nëse ndonjë prej këtyre termave dhe kushteve bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm për ndonjë arsye, vlefshmëria e dispozitave të mbetura dhe e dispozites në fjalë në masën që kjo fundit nuk është e pavlefshme ose e pazbatueshme, nuk do të ndikohet dhe Palët do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të zëvendësuar dispozitën e cila është e pavlefshme/e pazbatueshme me një dispozitë me efekt të ngjashëm.

18 Menaxhimi i Riskut të Palëve të Treta

Novartis pret që furnizuesi t'u përmbahet praktikave etike të biznesit dhe të respektojë Kodin e Palës së Tretë të Novartis dhe çdo kod tjetër, politika dhe udhëzim të zbatueshëm të Novartis. Duke ofruar mallra/shërbime/furnizime në përputhje me këtë Urdhër Blerjeje, furnizuesi pranon që:

- do të zbatojë Kodin e Palës së Tretë (dhe çdo azhurnim të publikuar) i cili mund të shikohet dhe shkarkohet nga <https://www.novartis.com/esg/reporting/codes-policies-and-guidelines> (furnizuesi mund të kërkojë një kopje falas nga Novartis);

- do të sigurojë informacionin/dokumentacionin mbi kërkesën e arsyeshme të Novartis, filialeve të saj dhe përfaqësuesve përkatës për të lejuar Novartis të verifikojë pajtueshmërinë me Kodin e Palës së Tretë në formën e kërkuar;
- do të bëjë përpjekjet më të mira për të korrigjuar mosrespektimet e identifikuara me Kodin e Palës së Tretë (aty ku është e mundur të korrigjohet) dhe të raportojë progresin e korrigjimit të Novartis, filialet e veta dhe përfaqësuesit përkatës sipas kërkesës;
- do të sigurojë që filialeve të furnitorit dhe/ose nënkontraktorëve/agjentëve të angazhuar drejtpërdrejt në ofrimin e mallrave/shërbimeve/furnizimeve në zbatim të këtij Urdhri Blerje t'u kërkohej gjithashtu të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat e mësipërme; dhe
- kur kërkohej nga Novartis, do të bashkëpunoni plotësisht (me shpenzimet e vetë furnizuesit) me Novartis dhe filialet e Novartis dhe përfaqësuesit përkatës në plotësimin dhe kthimin, sipas udhëzimeve të arsyeshme, të çdo pyetësi në lidhje me temat e pajtueshmërisë, duke përfshirë, pa kufizim, pajtueshmërinë kundër rryshfetit, që furnizuesi ka marrë si pjesë e proceseve të Menaxhimit të Riskut të Palës së Tretë të Novartis në çdo kohë dhe çdo përditësim të të njëjtit ("Pyetësor për Palët e Treta"). Furnizuesi garanton dhe përfaqëson se informacioni i dhënë në çdo Pyetësor për Palët e Treta (qoftë i dhënë para ose pas datës së këtij Urdhri Blerjeje, duke përfshirë përditësimet e të njëjtit) është i saktë dhe i plotë (dhe një informacion i tillë do të trajtohet si pjesë e marrëveshjes ndërmjet Novartis dhe furnizuesit në përputhje me këtë Urdhër Blerje). Për të shmangur dyshimin, ky nënparagraf zbatohet vetëm për furnizuesin, dhe jo për çdo nënkontraktor të angazhuar nga furnizuesi në përputhje me kushtet e këtij Urdhri Blerjeje (përfshirë në përputhje me dispozitat e Kodit të Palës së Tretë).

Shtatë ditë pune pas marrjes së një kërkesë me shkrim nga Novartis, furnizuesi do t'u lejojë partnerëve të Novartis (ose çdo auditori të palës së tretë të emëruar nga Novartis) akses të përshtatshëm në ambientet e furnizuesit dhe në çdo dokument/regjistër në lidhje me këtë Urdhër Blerjeje për qëllime të auditimit të pajtueshmërisë së detyrimeve të mësipërme.

Dështimi për t'iu përmbajtur ndonjëherë nga sa më sipër do t'i japë Novartis të drejtën të ndërpresë marrëveshjen midis furnizuesit dhe Novartis në përputhje me këtë Urdhër Blerjeje me efekt të menjëhershëm dhe pa kompensim të mëtejshëm. Furnizuesi konfirmon se ka lexuar dhe kuptuar versionin më të fundit të Kodit të Palës së Tretë Novartis.

19 Politikat

Furnizuesi do t'u përmbahet të gjitha politikave, procedurave, rregulloreve dhe rregullave që janë të zbatueshme në faqen e internetit publike të Novartis tek e cila Furnizuesi mund të ketë akses gjatë ofrimit të Shërbimeve.

20 Efekti Detyrues

Kjo Marrëveshje bëhet një marrëveshje përfundimtare dhe detyruese për Furnizuesin, me marrjen e UB, përveç nëse Furnizuesi dërgon një njoftim me shkrim për refuzimin e UB të Novartis brenda 24 orëve nga marrja e UB-së. Çdo ndryshim, modifikim ose shtesë e bërë në këtë Marrëveshje do të konsiderohet se nuk ka efekt, përveç nëse pranohet shprehimisht me shkrim dhe nënshkruhet nga një Përfaqësues i Novartis.

21 Klauzola Zëvendësuese

Cdo mospërputhje, paqartësi ose konflikt me: (1) kuotimin, propozimin ose ofertën e Furnizuesit; ose (2) Kushtet dhe Termat e përgjithshme; ose (3) çdo DP; ose (4) një marrëveshje e veçantë, do të zgjidhet në rendin vijues të përparësisë (ku (i) ka përparësinë më të lartë): (i) marrëveshje e veçantë; (ii) DP; (iii) Kushtet dhe Termat e Përgjithshme; dhe (iv) kuotimin, propozimin ose ofertën e furnizuesit.

22 Urdhër Blerje

Ky Urdhër Blerje miratohet në mënyrë dixhitale, sipas udhëzimeve të miratimit të Novartis, kështu që është i vlefshëm edhe pa nënshkrim.